



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Priljenos/Prudato Received/Delivery	16.10.2023	3 viti god ye q	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHOK	6556/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1135/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1135/2023 të datës 01.09.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit me nr. protokolli 74/2023 të datës 30.08.2023 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1135/2023 të datës 01.09.2023, të parashtruar nga ankuesi

Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Akt Emërimit me numër 01nr.112-1124 të datës 11.05.2017 në pozitën e punës "Zyrtar i Lart i Prokurimit" në kuadër të Departamentit Kabineti i Kryetarit, ankuesi më datë 01.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5917/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Vendimit me nr. protokolli 74/2023 të datës 30.08.2023 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.09.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, ndërsa Këshilli më datë 20.09.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 5917/2023 të datës 01.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [] për ankesa.kpmschck@rksgov.net i datës 01.09.2023; Certifikatë Themelore Profesionale për Prokurim e [] e vitit 2018-2020; B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 17.08.2023; B45 Letër standarde për tenderuesi e eliminuar i datës 17.08.2023; B45 Letër standarde për tenderuesi e eliminuar i datës 17.08.2023; B45 Letër standarde për tenderuesi e eliminuar i datës 17.08.2023; B58 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues 1/7 faqe; Njoftim për kontratë Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore [] i datës 30.12.2022; Autorizim nga Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore SH.A. për [] me numër protokoli 099 i datës 02.02.2022; Vendim për emërim dhe angazhim të përkohshëm të zyrtarit për udhëheqjen e procedurave të prokurimit për Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore SH.A. për [] me numër protokoli 038 i datës 02.06.2021; Vendim me numër 01nr.112-1124 i datës 11.05.2017; Akt Emërimi [] me numër 01nr.112-1124 i datës 11.05.2017; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim e [] me numër 435 e vitit 2021; Vendim i Komisionit Rregullativ të Prokurimit me numër protokoli 74/2023 i datës 30.08.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.09.2023; Përgjigje në ankesë e datës 20.09.2023; Kërkesë për anulim të certifikatës së prokurimit ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit të autoriteti kontraktues Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore e datës 30.06.2023; Shqyrtimi i kërkesës së OSHP-së të datës 30.06.2023, për anulimin e certifikatës profesionale të prokurimit për zyrtarin përgjegjës të prokurimit të autoritetit kontraktues Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qendrore SH.A për [] i datës 20.08.2023; Raporti i vlerësimit të tenderëve Rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit datë 22.05.2023; Vendim për rishqyrtim të kërkesës i datës 06.02.2023; Vendim për rishqyrtim të kërkesës i datës 29.05.2023; Raporti i ekspertit shqyrtues nr. i lëndës 2023/0361 i datës 12.06.2023; Raporti i ekspertit shqyrtues nr. i lëndës 2023/0093 i datës 03.03.2023; Vendim i Organit Shqyrtues të Prokurimit me numër OSHP: 2023/0093 i datës 08.05.2023; Procesverbali i hapjes së tenderit titulli i kontratës Furnizimi dhe montimi i paneleve solare në Kuzhinën Qendrore i datës 24.01.2023; E-mail i datës 15.09.2023; E-mail i datës 20.09.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, , si dhe kompetencën lëndore ka konstatuar se KPMSHCK, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi [] sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës ankuesi është i punësuar në Komunën e Prishtinës sipas Akt Emërimit me numër 01nr.112-1124 të datës 11.05.2017 në pozitën e punës "Zyrtar i Lart i Prokurimit" në kuadër të Departamentit Kabineti i Kryetarit. Ndërsa i njëjti sipas vendimit të Ushtruesit të detyrës së Kryeshefit

Ekzekutiv me numër protokolli 038 i datës 02.06.2021 është caktuar për emërim dhe angazhim të përkohshëm të zyrtarit për udhëheqjen e procedurave të prokurimit për Ndërmarrjen Publike Lokale N.P.L. "Kuzhina Qendrore" Sh.A. në pozitën e punës "Ushtrues detyre, "Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit" për Ndërmarrjen Publike Lokale N.P.L. "Kuzhina Qendrore" Sh.A.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N..06/L-114 për Zyrtarët Publik që kanë qenë në fuqi përkatësisht me nenin 2 paragrafin 4 ku është përcaktuar se; 2. *Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës...* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në pozitën e ankuesit "Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit" në Ndërmarrjen Publike Lokale N.P.L. "Kuzhina Qendrore" Sh.A., Kolegji i Këshillit konstatoi se në rastin konkret pozita "Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit" është e kategorizuar si nëpunës i Shërbimit Publik.*

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Andaj duke pas parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1135/2023 të datës 01.09.2023, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Andaj pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1135/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Udhëheqësit të Personelit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

